



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KRYETARI

Nr. 2936 prot.

Himarë, më 03.06 . 2024

URDHËR

Nr. 230 Datë 03/06/2024

PËR

**“PEZULLIMIN E PUNIMEVE TË SUBJEKTEVE QË JANË PAJISUR ME LEJE  
NDËRTIMI NGA BASHKIA HIMARË NË ZONËN TURISTIKE PËR PERIUdhËN  
03.06.2024-30.09.2024”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, ligjin Nr.44/2015 “Kodi I Procedurave Administrative”, ligjin Nr. 139/ 2015 datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM Nr.894/2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, VKM 171/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së rregullores të plazhit”, me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm , krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar ndotjet dhe zhurmat që vijnë si rezultat i ndërtimeve:

URDHËROJ:

- 1- Pezullimin e punimeve të subjekteve që janë pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Himarë në zonën turistike të Bashkisë Himarë, për peridhën 03.06.2024-30.09.2024
- 2- Periudha e pezullimit të punimeve, do t'i shtohet si afat periudhës së përfundimit të punimeve miratuar nga Bashkia.
- 3- Subjektet ndërtuese të marrin masa për rrethimin, veshjen e objektit ku po punohet me material estetike, për të krijuar mjedis miqësor me pushuesit vendas dhe të huaj.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet IMT Bashkia Himarë, Policia Bashkiake Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Të Territorit Himarë.  
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Blerina Bafa

